

“Ndryshime ligjore dhe administrative për rritjen e aksesit të grave në të drejtat pronësore”

Më datën 15 Maj 2017, në Tiranë u zhvillua tryeza konsultative me temë “Ndryshime ligjore dhe administrative për rritjen e aksesit të grave në të drejtat pronësore”, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Dhomën Kombëtare të Noterëve dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN WOMEN).

Kjo tryezë u organizua nga QNL në kuadrin e zbatimit të projektit “Mbështetje aksesit të grave në të drejtat pronësore përmes rritjes së nivelit të informacionit, këshillimit ligjor dhe ndërgjegjësimit.”

Në tryezë morën pjesë ekspertë si dhe anëtarë të stafit të QNL, të cilët përgatitën propozimet përkatëse për aktet ligjore dhe nënligjore në lidhje me aksesin e grave në të drejtat pronësore. Në të ishin të pranishëm edhe përfaqësues të dhomës kombëtare të Noterisë, përfaqësues të Zyrës Qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Noterë, avokatë, përfaqësues të OJF, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë, etj.

Tryeza u fokusua kryesisht në prezantimin propozimeve ligjore të përgatitura nga grupi i ekspertëve, prezantime të cilat u shoqëruan edhe me shpjegimet përkatëse me natyrë krahasuese me vende të tjera evropiane, në mënyrë që dispozitat ligjore të propozuara për ndryshim të jenë në harmoni me kërkesat e BE-së.

Gjatë prezantimit pati edhe diskutime praktike në lidhje me raste konkrete të cenimit të të drejtave pronësore të grave.

Foto nga aktiviteti



